



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:064786
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06151986

Ac.nr.6860/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Sh.B., B.I. rruga “...” nr..., K.M.-Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.S., avokat nga Prizreni, kundër debitorit A.O. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.K., avokat nga Prizreni, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.51/2022 të datës 22.09.2022, me datë 12.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Sh.B. B.I. rruga “...” nr..., K.M.-Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.51/2022 i datës 22.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.51/2022 të datës 22.09.2022, ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimi e debitorit të përmbartimit A.O. nga fshati K., Komuna e Prizrenit, i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.100/2022 t dt.03.03.2022, të përmbartuesit privat Mehdi Reshanii nga Prizreni dhe të njëjtin urdhër për përmbartim e ka shfuqizuar në tërësi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të ndryshoj aktvendimin e atakuar duke e vërtetuar urdhrin për përmbartim ose çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 03.03.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës 22SHV01-001-1 e datës 11.02.2022, lidhur me borxhin në vlerë prej 2,205.70 euro. Përmbartuesi privat, ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.100/22 të datës 03.03.2022, kundër këtij urdhri debitori nëpërmjet të autorizuarit të saj ka ushtruar prapësim nëpërmjet postës me datë 21.03.2022, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 24.03.2022. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka konstatuar se kreditori ka hartuar faturën në emër të pagesës, për shërbimet shëndetësore të kryera lidhur me shërimin dhe sanimin e dhëmbëve edhe pse në faturat në fjalë, është cekur afati për pagesën e detyrimit të në të holla e në frymën e nenit 30 të LPP-së, që ka të bëjë me kërkueshmërinë e kredisë nga fatura, si dokumente të besueshme, çështja e afatit të pagesës është e cekur (brenda afatit prej 7 ditëve), por pala debitore, të njëjtën faturë nuk e ka pranuar, dhe se të njëjtën faturë nuk e ka nënshkruar pala debitore, dhe se sipas vlerësimit të gjykatës, nuk janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 29, lidhur me nenin 37 të LPP-së, që të veprohet sipas propozimit për përmbartim të palës kreditore e për realizimin e detyrimit të saj në të holla e që rrjedh nga kjo faturë si dokument i besueshëm e që e kërkon nga pala debitore, derisa për prapësimin si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbartimit të ushtruar kundër një vendimi të nxjerrë në procedurën e përmbartimit, e në rastin konkret të Urdhrit për përmbartim të një përmbartuesi privat, si në rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 67, dhe 69 të LPP-së kurse për shkaqet e parapara e për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, ku kemi të bëjmë me faturë, si dokument i besueshëm e për shkak të detyrimit në të holla. Sipas vlerësimit të gjykatës, në shkresat e lëndës, gjendet origjinali i faturës, e njëjta nuk është e nënshkruar nga pala debitore dhe se për përshtatshmërinë për përmbartim të një fature, si dokument i besueshëm, bëhet fjalë në nenin 27 të LPP-së e në të cilin, thuhet se :''*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori ekzekutiv, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*'' dhe se kur kemi të bëjmë me një faturë e të cilën sipas gjendjes së shkresave të lëndës, pala debitore, nuk e ka nënshkruar, e kjo paraqet të metë që faturën ta bëjë të përshtatshme për përmbartim e për këtë bëhet fjalë në nenin 37 të LPP-së, dhe Udhëzimit Administrativ, nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit gjegjëse të Administratës Tatimore (ATK-së) e në të cilin parashihet nënshkrimi i një fature nga subjekti ekonomik. Ndërsa palët në procedurë, asgjë nuk i pengon që të inicojnë procedurë gjegjëse e me qëllim të të provuarit të pretendimeve të tyre sa i përket ekzistimit të detyrimit në të holla apo jo, duke qenë se në rastin konkret, ekziston njëri nga shkaqet që parashihet në nenin

37 dhe nenin 71 të LPP-së, e që ka të bëjnë me përshtatshmërinë për përmbardim, të një fature, si dokument i besueshëm, dhe i cili shkak, e pengon përmbardimin në këtë çështje juridike të përmbardimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2 pikën n) të LPK-së, për të cilat pretendon pala ankuese. Aktvendimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktvendimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e prapësimit. Në këtë kontekst në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, andaj kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore lidhur me dokumentin e besueshëm duke gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar prapësimin e debitorit ngase sipas nenit 40 të LPP-së, propozimi për përmbardim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë kërkesën përmbardimore nga paragrafi 1, të nenit 38 të LPP-së, ku parashihet se: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit”*, ndërsa me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht në nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: *“në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”*, andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se fatura në bazë të cilës është lejuar

përmbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit pasi që nuk është e pranuar dhe e nënshkruar nga debitori. Nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyrimi nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve apo shërbimeve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturave.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6860/2022, datë 12.09.2024

Gjyqtari
Hysni Bardheci